



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 4477 Prot

Peshkopi, më 06.11.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.79

Datë: 03.11.2025 si dhe projekt-vendimin nr.15 Datë 28.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FËMIJËT E FAMILJEVE NË
NEVOJË NË FSHATRA T QË NUK KANË SHKOLLË 9-VJEÇARE”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



Kapja
06.11.2025
[Signature]



4477/10/11/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1016/1 prot.

Peshkopi, më 10.11.2025

Lënda : Për vendimin nr.79, datë 03.11.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.79, datë 03.11.2025 “*Për miratimin e ndihmës financiare për fëmijët e familjeve në nevojë në fshatrat që nuk kanë shkollë 9-vjeçare*”, u vendos:

Miratimi në parim i vendimit objekt verifikimi të bazueshmërisë ligjore, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse dhe buxhetit të Bashkisë Dibër të vitit 2025, pjesë e përgjegjësisë direkte të strukturave të posaçme të bashkisë që paraqesin për miratim projekt-aktin.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 79 Datë 03 /11 /2025

**“PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FËMIJËT E FAMILJEVE NË
NEVOJË NË FSHATRA T QË NUK KANË SHKOLLË 9-VJEÇARE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.5, datë 15.01.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2025”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.31/1 prot, datë 20.01.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, të ndryshuar;Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.11.2025** me 18 vota pro 0 kundër 1 abstenim :

VENDOSI:

1. Të miratojë ndihmën financiare për fëmijët e familjeve në nevojë që udhëtojnë nga një fshat në tjetrin ose nga njësi të ndryshme administrative, për shkak të mungesës së shkollave 9-vjeçare në zonën e tyre, për vitin arsimor **2025–2026**.
2. Ndihma financiare do të jetë për vitin arsimor 2025 në vlerën **45,500** dhe ky fond do të mbulohet nga buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Dibër në zërin pagesë për qira objektsh dhe bonus qiraje të miratuar me buxhetin e vitit 2025.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Arsimit dhe Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall më datë **03.11.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KONOMIKE
SEKTORI I FINANCËS

PROJEKT-VENDIM

Nr. 15 Datë 28.10.2025

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FËMIJËT E FAMILJEVE NË NEVOJË
NË FSHATRA T QË NUK KANË SHKOLLË 9-VJEÇARE**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.5, datë 15.01.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2025”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.31/1 prot, datë 20.01.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, të ndryshuar;

KËRKOJMË:

1. Të miratojë ndihmën financiare për fëmijët e familjeve në nevojë që udhëtojnë nga një fshat në tjetrin ose nga njësi të ndryshme administrative, për shkak të mungesës së shkollave 9-vjeçare në zonën e tyre, për vitin arsimor 2025–2026.
2. Ndihma financiare do të jetë për vitin arsimor 2025 në vlerën **45,500** dhe ky fond do të mbulohet nga buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Dibër në zërin pagesë për qira objektsh dhe bonus qiraje të miratuar me buxhetin e vitit 2025.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Arsimit dhe Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtor Juridik

Ismet Saraçi

Drejtor Ekonomik

Çeljeta Zuna

Drejtor i Burimeve Njerëzore

Malbora Lala

KRYETARI

Rahim SPAHIU

**NË MUNGËSË DHE ME POROSI
ZËVENDËSKRYETARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E KONOMIKE
SEKTORI I FINANCËS

Nr. _____ prot.

Peshkopi, më _____ / _____ /2025

RELACION

MBI

**NDIHMËN FINANCIARE PËR FËMIJËT E FAMILJEVE NË NEVOJË NË FSHATRA T QË
NUK KANË SHKOLLË 9-VJEÇARE AFËR ZONËS SË BANIMIT**

Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.5, datë 15.01.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2025”;

Bashkia Dibër ka nën administrim **31 institucione arsimore**(5 prej të cilave shkolla të mesme të bashkuar), me rreth **4812 nxënës të klasave 1-9**, që ndjekin mësimet në këto shkolla. Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve detyrohen të udhëtojnë nga një fshat në tjetrin, apo edhe nga njësi të ndryshme administrative, për shkak se në vendbanimin e tyre nuk ka shkollë 9-vjeçare.

Për shumë prej këtyre familjeve, kushtet ekonomike të vështira e bëjnë të pamundur mbulimin e shpenzimeve të transportit të fëmijëve drejt shkollës, si dhe pajisjen me bazë materiale si mjete shkollore, veshmbathje etj.

Sipas kërkesave të prindërve dhe bashkëpunimit me drejtorët e shkollave, Sektori i Arsimit dhe Kulturës pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ekonomike kanë evidentuar rastet e familjeve me vështirësi ekonomike që kanë nevojë për mbështetje financiare.

Kërkesën nr 4337 datë 30.10.2025 të protokolluar në Bashkinë Diber për shërbimin e transportit të fëmijëve në fshtrat Lukan dhe Kacni në NJA Selishte i **propozojmë Këshillit Bashkiak Diber të miratojë dhënien e një ndihme financiare në masën 10, 500 lekë të rinj për vitin 2025.**

Kërkesën nr 521 datë 08.02.2024 të protokolluar në Bashkinë Diber për shërbimin e transportit të fëmijëve në lagjen Murate në NJA Luzni i **propozojmë Këshillit Bashkiak Diber të miratojë dhënien e një ndihme financiare në masën 15, 000 lekë të rinj për vitin 2025.**

Nga sa më sipër, i **propozojmë Këshillit Bashkiak Diber të miratojë dhënien e një ndihme financiare në masën 20 000 lekë të rinj për vitin 2025 për nxënësit e fshatit Zall Kalis që ndjekin mësimin pranë shkollës “Ajet Ndreu” Sillovë, për mbulimin pjesor të kostove të transportit të nxënësve që udhëtojnë në linjat e miratuara nga Bashkia Diber, kryesisht në zonat me terren të vështirë dhe distanca të gjata nga shkolla.**

Fondi në total për vitin 2025 është në vlerën 45,500

Mbështetja financiare do të mundësojë vijueshmërinë e procesit arsimor për fëmijët e familjeve në nevojë dhe do të kontribuojë në uljen e braktisjes shkollore në zonat rurale.

Për Bashkinë Diber

Drejtor Burime njerëzore Malbora Lala
Drejtor Ekonomik Çeljeta Zuna

